



PLANI VENDOR I MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE 2023-2027

0.1 Mbledhja e mbetjeve në qytetin e Korçës

0.1.1 Zona e shërbimit dhe popullsia

Qyteti i Korçës ndahet në 3 zona urbane: zona e vjetër e qytetit (zona 1/A dhe 1/B), zona perëndimore (zona 2) dhe zona jugore (zona 3), shihni Figura 1. Nga ana administrative, qyteti përbëhet nga 18 lagje. Popullsia gjithsej që jeton në qytetin e Korçës jepet rreth 70,000 banorë (rreth 23,150 familje). Përveç kësaj, ushtrojnë aktivitetin e tyre 1,800 biznese të vogla dhe 410 biznese të mëdha. Gjendja e rrugëve në zonat urbane është në përgjithësi e mirë, rrugë të shtruara me kalldrëm në zonat e vjetra të qytetit dhe rrugë më të gjera të asfaltuara në zonën perëndimore dhe jugore të qytetit.

0.1.2 Organizimi dhe përgjegjësitë

Bazuar në një kontratë shërbimi publik Bashkia Korçë ia kalon kompanisë private përgjegjësitë e mbledhjes së mbetjeve nga familjet dhe bizneset brenda zonave të përcaktuara dhe lagjeve të qytetit.¹

0.1.3 Logjistika dhe pajisjet

Operatori privat kryen aktivitetin me 5 kamionë teknologjik kompaktor, prej të cilëve

- 2 kamionë të vegjël kompaktor (Mitsubishi) përdoren kryesisht në zonën qendrore urbane, pra në zonat 1/A dhe 1/B që përbëjnë pjesën e vjetër të qytetit, me një ngarkesë maksimale prej 2 tonë secili.² Mjeti që shërben në lagjet 11 dhe 12 gjithashtu mbledh mbetjet në lagjet 6, 7 dhe 8, në zonat e banimit me shtëpi private. Mjeti tjetër që shërben në lagjet 1, 2 dhe 3 pjesërisht shërben edhe në disa zona me shtëpi private në lagjen 4. Për shkak të strukturës së

¹ Ofruesi privat i shërbimit është gjithashtu përgjegjës për pastrimin e rrugëve, pastrimin e dëborës, dhe shërbime të tjera që lidhen me pastrimin në zonat publike.

² Duke supozuar një dendësi të masës së mbetjeve prej 0.175 kg/l në zonat urbane llogaritet një ngarkesë me vëllim 10 m³ për kamion.



dendur të banesave dhe rrugëve të ngushta, shërbimi ofrohet me mbledhjen e qeseve të mbetjeve nga trotuaret ose derë më derë.

- 3 kamionë teknologjik kompaktor më të mëdhenj përdoren kryesisht në zonën e re urbane, i.e. në zonat 2 (perëndimore) dhe 3 (jugore): 2 njësi me ngarkesë maksimale prej 8 tonë dhe një me kapacitet 10 tonë³ që shërben në të dyja zonat, kryesisht në lagjet 16, 17 dhe përgjatë rrugëve kryesore me blloqe pallatesh në lagjet 6, 7 dhe 8. Këtu mbetjet mblihen nga kontenerët me kapacitet 1.1 m³ të vendosur në pika të përcaktuara për kontenerët përgjatë rrugëve të gjera. Në këto lagje urbane janë vendosur gjithsej 500 kontenerë publikë.

³ Duke supozuar një dendësi të masës së mbetjeve prej 0.175 kg/l në zonat urbane, vëllimi i ngarkesës llogaritet të jetë 45 m³ dhe 56 m³ për kamion, përkatësisht.




Figura 1 Zonat e shërbimit në lagjet urbane të qytetit të Korçës

0.1.4 Performanca aktuale e mbledhjes së mbetjeve

Mbledhja e mbetjeve kryhet përgjithësisht çdo ditë (përfshi fundjavën dhe festat) dhe secili nga kamionët kryen dy rrugë në ditë. Ndërsa në zonën e vjetër të qytetit, ku njerëzve u kërkohet t'i nxjerrin mbetjet në qese jashtë derës ose në trotuare, shërbimi ofrohet në orët e paradites, mbledhja e mbetjeve nga kontenierët publikë kryhet gjatë turnit të natës. Të gjitha mbetjet që mbledhen në zonat urbane transportohen në fushën e kontrolluar të mbetjeve të Korçës. Itinerari i detajuar dhe grafiku kohor i kryerjes së shërbimit nga operatori privat jepen në SHTOJCËN 2.

Bazuar në informacionin e dhënë nga supervizori, puna që kryhet nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve në zona të veçanta shërbimi është regjistruar në lidhje me distancën e përshkuar dhe kohën që i nevojitet mjetit për të bërë të gjitha rrugët e plota në një javë. Për rrjedhojë, janë specifikuar gjithsej distanca e përshkuar (km) dhe koha (orë) sa i përket udhëtimit drejt/ midis dhe brenda zonave të mbledhjes, transportit për në fushën e mbetjeve, shkarkimit dhe kthimit të mjetit në garazh ose në zonën tjetër të shërbimit. Përmbledhjet e performancës në zonat e ndryshme të shërbimit paraqiten në SHTOJCËN 3.

0.1.5 Kostot direkte të mbledhjes së mbetjeve

Shpenzimet fillestare të mjeteve llogariten mbi blerjen e mjeteve të reja. Mjetet e vjetra që janë pjesërisht ose plotësisht të amortizuara nuk janë marrë parasysh për llogaritjen e kostove. Supozohet që kamionët e rinj do të përdoren për një periudhë prej 10 vjetësh (jetëgjatësia), ndërsa kontenierët do të jenë në gjendje pune për 4 vjet. Një rezervë për mjetet në rast defekti të papritur, mirëmbajtjeje dhe riparimi është llogaritur me 10% të investimit fillestar.

Kostot e personelit llogariten në bazë të pagave bruto që përfshijnë 15% sigurime shoqërore dhe 1.5 % sigurime shëndetësore mbi pagat bazë (54,000 Lekë/muaj për shoferët, 40,000 Lekë/muaj për punëtorët e ngarkimit), një shtesë për mbikëqyrjen (10%) dhe një fond rezervë prej 10% në rast leje, raporti mjekësor dhe arsyeve të tjera të mungesës në punë. Kostot për taksa dhe siguracione llogariten në masën 1.5% në vit, të shpenzimeve fillestare për mjetet. Kostot e riparimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe kontenierëve llogariten në masën 5% në vit të vlerës fillestare të blerjes së tyre.

Kostot operative varen nga puna e kryer nga secili mjet dhe nga konsumi përkatës i karburantit, vajit të motorit dhe hidraulik dhe ndërrimit të gomave.



0.1.6 Vlerësimi dhe pasojat për të ardhmen

Rezultatet e llogaritjeve të performancës dhe kostos janë përmbledhur si më poshtë:

- Bazuar në supozimet rreth aftësisë mbajtëse specifike të kamionëve teknologjik kompaktor, ngarkesa totale e mbetjeve të mbledhura nga zonat rurale përlllogaritet rreth 13 tonë në ditë.
- Gjatë një viti, bëhen rreth 3.640 rrugë për në Landfillin Rajonal te Maliqit me një ngarkesë mesatare prej 1.8 tonë/ rrugë me kompaktorët e vegjël dhe një ngarkesë prej midis 4-6 tonë/ rrugë me kompaktorët e mëdhenj. Distanca mesatare e udhëtimit është rreth 16 km për një rrugë të plotë.
- Përgjithësisht, kostot për njësi të kamionëve të vegjël kompaktor (21 €/t), të cilët përdoren për mbledhjen e qeseve nëpër rrugët e ngushta të pjesës së vjetër të qytetit – duke harxhuar shumë kohë, janë rreth 3-4 herë më të larta se ato të kamionëve teknologjik kompaktor më të mëdhenj dhe shumë më ekonomikë (7 €/t) që mbledhin mbetjet nga kontenierët publikë me kapacitet 1.1 m³.
- Kostot specifike më të larta të kamionëve të vegjël teknologjik (mbi 21 €/t) shoqërohen me cilësi më të lartë shërbimi, pasi kamionët mund të manovrojnë afër shtëpive në rrugët e ngushta, ndërsa banorët në zonat më të reja të qytetit duhet t'i sjellin mbetjet në kontenierët publikë, një shërbim që ofrohet me koston për njësi më pak se 7 €/t.
- Në përgjithësi, cilësia e shërbimit të ofruar nga kontraktori është e kënaqshme dhe duket se mbledhja e mbetjeve menaxhohet mirë, siç tregon pastërtia e rrugëve kryesore dhe trotuareve, si edhe mirëmbajtja e kontenierëve dhe pikave të tyre nëpër qytet.

Mbledhja e mbetjeve në fshatra

0.1.7 Zona e shërbimit dhe popullsia

Vendbanimet rurale të Bashkisë Korçë përbëhen nga njësitë administrative të Drenovës, Bulgarecit, Voskopit, Voskopojës, Mollajt, Vithkuqit dhe Lekasit, siç paraqiten në Figura 2.




Figura 2 Zonat rurale të Bashkisë Korçë

Qendra banimi të vogla rurale janë të shpërndara në një zonë të gjerë dhe pjesërisht malore dhe një popullsi prej rreth 33,500 banorë (10,462 familje) jetojnë në 63 fshatra. Rreth 280 biznese janë të regjistruara në këtë zonë.

Gjendja e rrugëve dhe qarkullimi në vendbanimet rurale me kamionë paraqiten të ndryshme dhe ndikojnë ndjeshëm në efektivitetin dhe efikasitetin e kostos të shërbimeve të mbledhjes së mbetjeve.

- **Drenovë:** Qendra e njësisë administrative dhe pjesa më e madhe e vendbanimeve mund të shërbehet me kamionët e mbledhjes së mbetjeve. Dardha, megjithëse ndodhet larg në zonë malore, lidhet me rrugë të asfaltuara, por mbledhja e mbetjeve në rrugët e ngushta e të pjerrëta me kalldrëm të fshatit harxhon shumë kohë.
- **Bulgarec:** Në periferi të qytetit të Korçës vendbanimet e Bulgarecit dhe Çifligut, në perëndim të rrugës nacionale për në Maliq, janë të qarkullueshme nga kamionët. Fshatrat në lindje përgjatë rrugës nacionale për në Bilisht (Dishnicë,



Neviçisht, Belorta, Kuç i Zi) kanë rrugë të asfaltuara vetëm në hyrjen kryesore të tyre. Qarkullimi i kamionëve në fshatrat e tjerë (Lumalas, Biranj, Melçan, Porodinë, Malavec, Shamoll dhe Barç) me rrugë të shtruara me çakull është i vështirë për sa kohë rrugët nuk janë të asfaltuara. Rehabilitimi i segmentit rrugor midis Porodinës dhe Melçanit do të ofronte një rrugë të shkurtër për transportin e mbetjeve nga Voskopi dhe Voskopoja për në vend depozitimin e Maliqit në të ardhmen.

- **Voskop:** Vetëm qendra e njësisë administrative është e qarkullueshme nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve. Në të gjithë fshatrat e tjerë, vetëm hyrja kryesore e tyre është (pjesërisht) e asfaltuar, rrugët e tjera janë të shtruara me çakull. Në Damjanec nuk ka shërbim për shkak të pamundësisë së mjeteve për të qarkulluar.
- **Voskopojë:** Vetëm qendra e njësisë administrative është e qarkullueshme nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve në rrugët e shtruara me kalldrëm. Në të gjithë fshatrat e tjerë, vetëm rruga kryesore hyrëse është (pjesërisht) e asfaltuar, rrugët e tjera dytësore janë vetëm me çakull.
- **Mollaj:** Vetëm qendra e njësisë administrative Mollaj është e qarkullueshme nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve. Në të gjithë fshatrat e tjerë, vetëm rruga hyrëse kryesore është (pjesërisht) e asfaltuar, ndërsa rrugët dytësore janë të shtruara me çakull. Shërbimi ofrohet në të gjithë fshatrat.
- **Vithkuq:** Qendra e njësisë administrative dhe fshatrat Shtyllë, Leshnjë dhe Gjanç janë të qarkullueshme nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve në rrugët kryesore të asfaltuara. Rrugët dytësore janë vetëm të shtruara me çakull.

0.1.8 Organizimi dhe përgjegjësitë

Spektori i menaxhimit të mbetjeve të ngurta është organizuar në varësi të Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave të Bashkisë Korçë.. Administratorët e njësive administrative⁴ dhe kryetarët e fshatrave informojnë për shërbimin. Kufijtë e mëparshëm administrativë janë ruajtur brenda organizimit të zgjeruar të shërbimeve bashkiake për mbledhjen e mbetjeve.

0.1.9 Logjistika dhe pajisjet

Mbledhja dhe transporti i mbetjeve kryhet vetëm me kamionët vetëshkarkues me karroceri të sheshtë me kapacitet 6 m³, ose me kamionë të hapur me kapacitet 3-6 m³. Modeli më i

⁴ Shihni listën e personave përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve në SHTOJCËN 1.

përhapur është mbledhja me qese dhe vetëm në pak vende përdoren kontenerë ose kosha.

0.1.10 Performanca aktuale e mbledhjes së mbetjeve

Mbledhja e mbetjeve në një fshat zakonisht kryhet një ose dy herë në javë dhe kamionët kryejnë 1-3 rrugë në ditë. Për shkak të mundësisë së kufizuar për të qarkulluar me kamionë deri nëpër shtëpi, banorëve u kërkohet t'i sjellin mbetjet e tyre në qese deri në rrugën kryesore, ose punëtorët duhet t'i mbledhin ato nga familjet e fshatit. Kjo bën që shërbimi në fshatra të harxhojë shumë kohë.

.

Informacion i detajuar mbi popullsinë dhe sasinë e mbetjeve të mbledhura, një vlerësim i gjendjes së rrugëve në fshatra dhe detaje të grafikut kohor të shërbimeve të mbledhjes së mbetjeve paraqiten për secilën zonë shërbimi në SHTOJCËN 4.

Bazuar në informacionin e dhënë nga supervizorët e njësive administrative, puna e kryer nga kamionët e mbledhjes së mbetjeve në zona të veçanta shërbimi është regjistruar, sa i përket distancës së përshkuar dhe kohës së nevojshme për të gjitha rrugët që kryen mjeti gjatë një jave. Rrjedhimisht, janë specifikuar distanca në total (km) dhe koha (orë) që lidhet me udhëtimin drejt/ midis dhe brenda zonave të mbledhjes së mbetjeve, me transportin deri në fushën e mbetjeve, shkarkimin dhe kthimin e mjetit në garazh apo në zonën tjetër të shërbimit. Grafikët e detajuar të punës për kamionët e mbledhjes së mbetjeve në zonat përkatëse paraqiten në SHTOJCËN 5.

Performanca dhe kostoja		Njësi	Zonat e shërbimit							Total
			Drenovë	Bulgareci Lindor	Bulgareci Perëndimor	Voskop	Voskopojë	Mollaj	Vithkuq	
Performanca	Mbetjet e mbledhura	t/vit	1,098 t	1,304 t	1,030 t	412 t	309 t	618 t	103 t	4,873 t
	Distanca e përshkuar	km/vit	16,874	15,340	14,976	9,256	5,824	12,350	8,346	82,966
	Rrugët e kryera	rrugë/vit	832	780	780	312	468	312	156	3,640
Koha	Udhëtimi	h/javë	5.08	1.75	2.08	1.83	2.08	2.92	2.50	18.25
	Mbledhja	h/javë	27.25	22.75	23.25	34.00	36.00	37.50	15.00	195.75
	Transporti në distancë	h/javë	4.00	5.00	3.83	3.00	1.92	2.92	0.75	21.42
	Shkarkimi	h/javë	4.00	3.75	3.75	1.50	2.25	1.50	3.75	20.50
	Kthimi	h/javë	3.92	3.08	4.00	2.00	0.75	2.00	1.50	17.25
	Koha gjithsej	h/javë	44.25	36.33	36.92	42.33	43.00	46.83	23.50	273.17
Kosto e mjeteve	Kamionët e nevojshëm	nr.	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	7.0
	Kosto kapitale vjetore	€/vit	2,750 €	2,750 €	780 €	2,750 €	550 €	2,750 €	550 €	12,880 €
	Kosto operative vjetore	€/vit	18,700 €	18,308 €	18,215 €	16,755 €	14,448 €	17,545 €	15,092 €	119,064 €
	Total kosto direkte vjetore	€/vit	21,450 €	21,058 €	20,965 €	19,505 €	14,998 €	20,295 €	15,642 €	133,914 €
Kosto/ njësi	Kosto për ton	€/t	19.53 €	16.15 €	20.36 €	47.36 €	48.56 €	32.85 €	151.93 €	27.48 €
	Kosto për km	€/km	1.27 €	1.37 €	1.40 €	2.11 €	2.58 €	1.64 €	1.87 €	1.61 €
	Kosto për rrugë	€/trip	29.46 €	27.00 €	26.88 €	62.52 €	32.05 €	65.05 €	100.27 €	36.79 €

1 Optimizimi i mbledhjes së mbetjeve në zonat rurale

1.1 Supozimet kryesore për planifikimin

1.1.1 Pajisjet e duhura të transportit



Gjetja kryesore nga vlerësimi i situatës aktuale është se kamionët e mbledhjes së mbetjeve punojnë me kapacitete shumë të vogla. Hapi i parë për optimizimin e sistemit është të rritet aftësia mbajtëse e kamionëve, deri në masën që lejon qarkullimin e tyre në rrugët e ngushta e ndonjëherë të pjerrëta të fshatrave.

Për rrjedhojë, propozohet të investohet në blerjen e më shumë kamionëve të përshtatshëm e me efikasitet kostoje për mbledhjen e mbetjeve, të cilët mund të mbajnë sasi më të mëdha mbetjesh, duke ulur në këtë mënyrë numrin e rrugëve në distanca të largëta për në vend depozitimit sanitare të Maliqit.

Përmirësimi kohët e fundit i mbledhjes së mbetjeve në pjesën e vjetër të qytetit të Korçës me kamionë kompaktor të vegjël jep prova se e njëjta qasje mund të ndiqet për mbledhjen e mbetjeve në fshatra. Më poshtë jepen specifikimet paraprake për një kamion të vogël kompaktor të përshtatshëm, i cili mund të mbajë një ngarkesë deri në 2.9 tonë mbetje të

ngjeshura (që është 2 herë më e lartë se ngarkesa e një kamioni vetëshkarkues të thjeshtë).

Tabela 1 Krahasimi i kapaciteteve të transportit – kamioni kompaktor krahasuar me kamionin vetëshkarkues

Të dhëna teknike	Njësi	Kamion teknologjik kompaktor	Kamion vetëshkarkues
			
Pesha maksimale totale	t	8.50	6.60
Shasia	t	4.00	4.00
Trupi	t	1.00	0.60
Pajisja ngritëse	t	0.30	0.00
Ngarkesa (pesha)	t	3.20	2.00
Kapaciteti i karrocërësë	m ³	7.00	13.00
Pesha për vëllim e trupit	kg/m ³	0.46	0.20
Dendësia e masës së mbetjeve shtëpiake të përziera	kg/m ³	0.20	0.20
Norma e ngjeshjes	1 : ...	2.3	1.0
Shfrytëzimi mesatar i kapacitetit	%	90%	50%
Ngarkesa (vëllimi)	m³	14.4	6.5
Ngarkesa aktuale për kamion	t/kamion	2.9	1.3

1.1.2 Mbledhja e mbetjeve në qese

Diskutimet e zhvilluara me personat përgjegjës për mbledhjen e mbetjeve në zonat rurale sollën përfundimin se përdorimi i kontenierëve me kapacitet 1.1 m³ për grumbullimin e mbetjeve nuk shihet si i përshtatshëm. Në këtë kontekst u përmendën disa arsye:

- Në rrugët e ngushta mungon ose ka vetëm një hapësirë të kufizuar për të vendosur kontenierë.
- Kontenierët me rrota është e vështirë të lëvizin në rrugë dheu, çka do të shkaktonte shumë dëmtim dhe konsumim të tyre.
- Kontenierët e hapur në vende publike tërheqin grumbullimin e mbetjeve të paautorizuara, si mbetje inerte të ndërtimit, mbetje të gjelbra, etj.

Mundësia e vendosjes së kontenierëve në vendet pranë hyrjes së fshatrave u kundërshtua gjithashtu për të njëjtat arsye, si edhe për kostot shtesë që do të ketë blerja e mirëmbajtja e kontenierëve.



Rrjedhimisht, mbledhja me qese duket një qasje më e përshtatshme në zonat rurale. Megjithatë, kjo kërkon punë e përpjekje në ndërgjegjësimin e banorëve të fshatrave mbi përgjegjësinë që ata kanë për t'i nxjerrë qeset e mbetjeve në rrugët kryesore hyrëse, në të cilat mund të qarkullojnë kamionët, ose t'ua dorëzojnë qeset e mbetjeve dy punëtorëve që shoqërojnë kamionin.

Banorët duhet të kenë informacion të qartë mbi grafikun e rregullt të mbledhjes së mbetjeve, në mënyrë që ata të dinë ditët (2 here në javë) dhe orën kur kamioni mbërrin në fshat për të nxjerrë mbetjet në vendet e përcaktuara apo për t'i ngarkuar direkt mbi kamion në kohën e duhur.

Ndërgjegjësimi i publikut dhe komunikimi i mirë midis ofruesit të shërbimit, kryetarëve të fshatrave dhe popullsisë është një kusht i domosdoshëm për të mbajtur një sistem efektiv që redukton në minimum kohën dhe koston e mbledhjes së mbetjeve.

1.1.3 Zonat e reja të shërbimit

Me zgjerimin e kufijve administrativë të Bashkisë Korçë, organizimi i shërbimeve të mbledhjes së mbetjeve nga administratat e mëparshme të njësive administrative do të shpërbëhet dhe do të ngrihet nga bashkia. Për pasojë, kjo do të japë shkas për ripërcaktimin e zonave të shërbimit dhe itinerareve në mënyrë të tillë që kamionët e mbledhjes së mbetjeve të mund të punojnë me efikasitet. Në Figura 3 paraqitet një propozim për zonat e reja të shërbimit.




Figura 3 Zonat e shërbimit të propozuara në zonat rurale të Bashkisë Korçë

Sipas këtij organizimi parashikohen vetëm katër zona shërbimi, si më poshtë:

- *Zona Verilindore* përfshin fshatrat që ndodhen në anën lindore të rrugës nacionale për në Maliq dhe fshatrat përgjatë rrugës nacionale për në Bilisht (Bulgareci Lindor).
- *Zona Juglindore* mbulon fshatrat e njësisë administrative Drenovë dhe fshatrat e Polenës dhe Dërsnikut (njësia administrative Voskop).
- *Zona Veriperëndimore* përfshin fshatrat e njësive administrative Voskop dhe Voskopojë (përveç Polenës dhe Dërsnikut) dhe fshatrat që ndodhen përgjatë anës perëndimore të rrugës nacionale për në Maliq (Bulgareci Lindor).
- *Zona Jugperëndimore* mbulon fshatrat e njësisë administrative Mollaj dhe fshatrat ku ofrohet shërbim në njësitë administrative Mollaj dhe Vithkuq.

Kjo ndarje e re e zonave të shërbimit të pastrimit (shihni Figurën 3) do të kishte ndikim gjithashtu edhe në organizimin, funksionimin dhe në stafin e administratës që punon në njësitë administrative, siç tregohen në Figurën 2.

1.2 Itineraret e propozuara për shërbimin

Duke marrë parasysh sasinë e mbetjeve që prodhohen, distancën e udhëtimit midis fshatrave, distancën e transportit për në vend depozitimit dhe kohën e veprimtarisë së mbledhjes dhe transportit, janë hartuar itineraret e shërbimit në bazë të procedurës së mëposhtme:

- Në përpjestim me numrin e dhënë të banorëve, totali i mbetjeve të mbledhura është shpërndarë nëpër fshatrat që ndodhen në katër zonat e shërbimit.
- Një kapacitet i përshtatshëm që do t'i lejonte kamionët e vegjël kompaktor të hynin dhe të manovronin brenda fshatrave në rrugë të ngushta, por të asfaltuara supozohet të jetë 3 tonë për njësi. Supozohet që një kamion me këtë kapacitet mund të shërbejë në të gjithë fshatrat e një zone shërbimi, pra 4 kamionë kompaktor nevojiten për të shërbyer në të gjitha zonat rurale të Bashkisë Korçë.
- Sasinë ditore të mbetjeve që duhet të mbledhen nga çdo fshat janë llogaritur duke marrë parasysh frekuencën e shërbimit.
- Garazhet e kamionëve ndodhen pranë qendrave kryesore të prodhimit të mbetjeve në zonat përkatëse të shërbimit.
- Të dhënat mbi distancat e udhëtimit të mjetit nga garazhi deri në zonat e shërbimit dhe brenda tyre, ashtu si edhe mbi distancat e transportit drejt/nga vend depozitimi në Maliq janë llogaritur sipas hartave të Google. Distancat e udhëtimit për mbledhjen e mbetjeve brenda fshatrave janë llogaritur me 1-2 km, në varësi të numrit të popullsisë.
- Koha e udhëtimit llogaritet mbi supozimin se kamionët mund të lëvizin me shpejtësi mesatare 35 km/h.
- Koha që nevojitet për mbledhjen e mbetjeve brenda fshatrave llogaritet një orë për ton mbetje, në vend të kohës që nevojitet në sistemin aktual, dy orë për ton mbetje. Ky reduktim i theksuar i kohës përgjysëm mund të arrihet duke pasur një organizim më të mirë, me zbatimin strikt të grafikëve kohorë nga ana e operatorit, me një kontribut më të madh nga banorët e fshatit për t'i sjellë mbetjet sa më afër kamionëve dhe me një rendiment më të lartë të punëtorëve, të cilët aktualisht punojnë jo vetëm për mbledhjen, por dhe vendosjen e mbetjeve mbi kamion.

- Shkarkimi i mbetjeve në vend depozitim mund të realizohet brenda një çerek ore dhe me një manovër në 1 km.

Bazuar në supozimet e mësipërme, planet e itinerareve të katër zonave të shërbimit prezantohen më poshtë.

Zona Verilindore: Itinerari fillon nga garazhi në Bulgarec dhe në të gjithë fshatrat ka shërbim 2 herë në javë.

Tabela 2 Plani i propozuar për Zonën Verilindore

Zona e shërbimit - Grafiku kohor - Ngarkesa e mbetjeve					Mbledhja		Udhëtimi		Shkarkimi		Performanca		
zona	turni	fillimi	mbarimi	t/dite	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	
Verilindje	E hene/ e merkure/ e premte	paradite	Garazh, Bulgarec	Kuc i Zi			13 km	0.36			13 km	0.36 h	
			Kuc i Zi	Belorta	0.92 t	1 km	0.92 h	2 km	0.04			3 km	0.97 h
			Belorta	Ciflig	1.38 t	1 km	1.38 h	10 km	0.29			11 km	1.67 h
			Ciflig	Vend depozitim Maliq	0.55 t	1 km	0.55 h	15 km	0.41	1 km	0.25 h	17 km	1.21 h
			Vend depozitim Maliq	Nevisisht				21 km	0.60			21 km	0.60 h
		pasdite	Nevisisht	Dishnice	0.72 t	1 km	0.72 h	3 km	0.07			4 km	0.80 h
			Dishnice	Malavec	2.08 t	1 km	2.08 h	2 km	0.04			3 km	2.13 h
			Malavec	Vend depozitim Maliq	0.32 t	1 km	0.32 h	20 km	0.57	1 km	0.25 h	22 km	1.14 h
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Bulgarec				13 km	0.36			13 km	0.36 h
	E hene/ e merkure/ e premte				5.98 t	6 km	5.98 h	96 km	2.74	2 km	0.50 h	104 km	9.23 h
	E marte/ e enjte/ e shtune	paradite	Garazh, Bulgarec	Shamoll			4 km	0.10			4 km	0.10 h	
			Shamoll	Bulgarec	0.83 t	1 km	0.83 h	4 km	0.10			5 km	0.93 h
			Bulgarec	Ciflig	1.40 t	2 km	1.40 h	5 km	0.13			7 km	1.53 h
			Ciflig	Vend depozitim Maliq	0.55 t	1 km	0.55 h	15 km	0.41	1 km	0.25 h	17 km	1.21 h
		pasdite	Vend depozitim Maliq	Bulgarec				13 km	0.36			13 km	0.36 h
			Bulgarec	Barc	1.40 t	2 km	1.40 h	8 km	0.23			10 km	1.63 h
			Barc	Vend depozitim Maliq	1.51 t	1 km	1.51 h	17 km	0.49	1 km	0.25 h	19 km	2.24 h
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Bulgarec				13 km	0.36			13 km	0.36 h
E marte/ e enjte/ e shtune				5.70 t	7 km	5.70 h	76 km	2.17	2 km	0.50 h	85 km	8.37 h	

Zona Juglindore: Itinerari fillon nga garazhi në Drenovë dhe në të gjithë fshatrat ka shërbim 2 herë në javë .

Tabela 3 Plani i propozuar për Zonën Juglindore

Zona e shërbimit - Grafiku kohor - Ngarkesa e mbetjeve					Mbledhja		Udhëtimi		Shkarkimi		Performanca		
zona	turni	fillimi	mbarimi	t/dite	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	
Juglindje	E hene/ e merkure/ e premte	paradite	Garazhi, Drenove	Mborje			3 km	0.07			3 km	0.07 h	
			Mborje	Vend depozitim Maliq	2.53 t	2 km	2.53 h	19 km	0.54	1 km	0.25 h	22 km	3.32 h
			Vend depozitim Maliq	Drenove				20 km	0.57			20 km	0.57 h
		pasdite	Drenove	Morave	1.03 t	2 km	1.03 h	1 km	0.01			3 km	1.05 h
			Morave	Turan	1.18 t	2 km	1.18 h	8 km	0.21			10 km	1.39 h
			Turan	Vend depozitim Maliq	0.44 t	1 km	0.44 h	18 km	0.50	1 km	0.25 h	20 km	1.19 h
			Vend depozitim Maliq	Garazhi, Drenove				20 km	0.57			20 km	0.57 h
	E hene/ e merkure/ e premte				5.18 t	7 km	5.18 h	87 km	2.49	2 km	0.50 h	96 km	8.17 h
	E marte/ e enjte/ e shtune	paradite	Garazhi, Drenove	Dardha				16 km	0.46			16 km	0.46 h
			Dardhe	Boboshtice	0.14 t	1 km	0.14 h	11 km	0.31			12 km	0.46 h
			Boboshtice	Ravonik	0.30 t	1 km	0.30 h	10 km	0.27			11 km	0.57 h
			Ravonik	Vend depozitim Maliq	0.86 t	1 km	0.86 h	19 km	0.53	1 km	0.25 h	21 km	1.64 h
			Vend depozitim Maliq	Qatrom				21 km	0.60			21 km	0.60 h
		pasdite	Qatrom	Polene	0.56 t	1 km	0.56 h	4 km	0.11			5 km	0.68 h
			Polene	Dersnik	0.29 t	1 km	0.29 h	5 km	0.13			6 km	0.42 h
			Dersnik	Vend depozitim Maliq	0.52 t	1 km	0.52 h	32 km	0.91	1 km	0.25 h	34 km	1.69 h
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Drenove				20 km	0.57			20 km	0.57 h
			E marte/ e enjte/ e shtune				2.67 t	6 km	2.67 h	137 km	3.90	2 km	0.50 h

Zona Veriperëndimore: Itinerari fillon nga garazhi në Voskop. Vetëm fshatrat më të mëdhenj të Voskopojës, Voskopit, Goskovës dhe Porodinës shërbehen 2 herë në javë

Zona Jugperëndimore: Itinerari fillon nga garazhi në Mollaj. Vetëm fshatrat më të mëdhenj Mollaj, Kamenicë dhe Floq shërbehen 2 herë në javë, Për shkak të distancave të largëta në Vithkuq bëhet vetëm një rrugë në javë.



Tabela 4 Plani i propozuar për Zonën Veriperëndimore

Zona e shërbimit - Grafiku kohor - Ngarkesa e mbetjeve					Mbledhja		Udhëtimi		Shkarkimi		Performanca			
zona	turni	fillimi	mbarimi	t/dite	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha		
Veriperëndim	E hene/ e merkure/ e preme	paradite	Garazh, Voskop	Shipske			16 km	0.46			16 km	0.46 h		
			Shipske	Voskopoje	0.12 t	1 km	0.12 h	5 km	0.14			6 km	0.26 h	
			Voskopoje	Voskop	0.89 t	1 km	0.89 h	11 km	0.31			12 km	1.21 h	
			Voskop	Vend depozitim Maliq	0.92 t	2 km	0.92 h	23 km	0.64	1 km	0.25 h	26 km	1.81 h	
			Vend depozitim Maliq	Goskove Lart				22 km	0.61			22 km	0.61 h	
			Goskove Lart	Goskove Poshte	0.41 t	1 km	0.41 h	1 km	0.03			2 km	0.44 h	
			Goskove Poshte	Porodine	0.20 t	1 km	0.20 h	3 km	0.09			4 km	0.29 h	
		pasdite	Porodine	Vend depozitim Maliq	1.10 t	1 km	1.10 h	16 km	0.44	1 km	0.25 h	18 km	1.79 h	
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Voskop				23 km	0.64			23 km	0.64 h	
			E hene/ e merkure/ e preme		3.64 t	7 km	3.64 h	118 km	3.37	2 km	0.50 h	127 km	7.51 h	
		E marte	paradite	Garazh, Voskop	Gjonomadh			7 km	0.20			7 km	0.20 h	
				Gjonomadh	Lavdar	1.02 t	2 km	1.02 h	2 km	0.06			4 km	1.08 h
				Lavdar	Damjanec	0.43 t	1 km	0.43 h	16 km	0.46			17 km	0.89 h
				Damjanec	Vincan	0.14 t	1 km	0.14 h	2 km	0.06	1 km	0.25 h	4 km	0.44 h
	Vincan			Vend depozitim Maliq	0.31 t	1 km	0.31 h	24 km	0.67			25 km	0.99 h	
	Vend depozitim Maliq			Melcan				12 km	0.34			12 km	0.34 h	
	pasdite		Melcan	Lumalas	0.90 t	1 km	0.90 h	3 km	0.09			4 km	0.98 h	
			Lumalas	Biranj	0.87 t	1 km	0.87 h	1 km	0.01			2 km	0.89 h	
			Biranj	Vend depozitim Maliq	1.51 t	1 km	1.51 h	9 km	0.26	1 km	0.25 h	11 km	2.01 h	
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Voskop				23 km	0.64			23 km	0.64 h	
	E marte			5.18 t	8 km	5.18 h	98 km	2.79	2 km	0.50 h	108 km	8.46 h		
	E enjte		paradite	Garazh, Voskop	Melcan			7 km	0.20			7 km	0.20 h	
				Melcan	Lumalas	0.90 t	1 km	0.90 h	3 km	0.09			4 km	0.98 h
				Lumalas	Biranj	0.87 t	1 km	0.87 h	1 km	0.01			2 km	0.89 h
		Biranj		Vend depozitim Maliq	1.51 t	1 km	1.51 h	9 km	0.26	1 km	0.25 h	11 km	2.01 h	
		Vend depozitim Maliq		Gjonomadh				29 km	0.81			29 km	0.81 h	
		pasdite	Gjonomadh	Lavdar	1.02 t	2 km	1.02 h	2 km	0.06			4 km	1.08 h	
			Lavdar	Damjanec	0.43 t	1 km	0.43 h	16 km	0.46			17 km	0.89 h	
Damjanec			Vincan	0.14 t	1 km	0.14 h	2 km	0.06			3 km	0.19 h		
Vincan			Vend depozitim Maliq	0.31 t	1 km	0.31 h	24 km	0.67	1 km	0.25 h	26 km	1.24 h		
Vend depozitim Maliq			Garazh, Voskop				23 km	0.64			23 km	0.64 h		
E enjte		5.18 t	8 km	5.18 h	92 km	2.61	2 km	0.50 h	124 km	8.94 h				

Tabela 5 Plani i propozuar për Zonën Jugperëndimore

Zona e shërbimit - Grafiku kohor - Ngarkesa e mbetjeve				Mbledhja		Udhëtimi		Shkarkimi		Performanca			
zona	turni	fillimi	mbarimi	t/dite	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	distanca	koha	
Jugperëndim	E hene	paradite	Garazh, Mollaj	Mollaj			1 km	0.03			1 km	0.03 h	
			Mollaj	Vend depozitim Maliq	1.54 t	2 km	0.00 h	23 km	0.64		25 km	0.64 h	
			Vend depozitim Maliq	Bellodove				31 km	0.89	1 km	0.25 h	32 km	1.14 h
		pasdite	Bellodove	Pulahe	0.41 t	1 km	0.41 h	4 km	0.11			5 km	0.53 h
			Pulahe	Q. Mollaj	0.83 t	1 km	0.83 h	6 km	0.17			7 km	1.00 h
			Q. Mollaj	Vend depozitim Maliq	0.08 t	1 km	0.08 h	25 km	0.70	1 km	0.25 h	27 km	1.03 h
		E hene	Vend depozitim Maliq	Garazh, Mollaj				23 km	0.64			23 km	0.64 h
	E hene				2.86 t	5 km	1.32 h	112 km	3.19	2 km	0.50 h	119 km	5.01 h
	E marte	paradite + pasdite	Garazh, Mollaj	Floq				9 km	0.24			9 km	0.24 h
			Floq	Kamenice	0.99 t	1 km	0.99 h	7 km	0.20			8 km	1.19 h
			Kamenice	Shtylle	1.32 t	1 km	1.32 h	28 km	0.80			29 km	2.12 h
			Shtylle	Vithkuq	0.08 t	1 km	0.08 h	11 km	0.31			12 km	0.40 h
			Vithkuq	Leshnje	0.59 t	1 km	0.59 h	5 km	0.14			6 km	0.73 h
			Leshnje	Gjanc	0.25 t	1 km	0.25 h	5 km	0.13			6 km	0.38 h
			Gjanc	Vend depozitim Maliq	0.06 t	1 km	0.06 h	37 km	1.06	1 km	0.25 h	39 km	1.37 h
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Mollaj				23 km	0.64			23 km	0.64 h
	E marte			3.30 t	6 km	3.30 h	124 km	3.53	1 km	0.25 h	131 km	7.08 h	
	E merkure	paradite	Garazh, Mollaj	Mollaj				1 km	0.03			1 km	0.03 h
			Mollaj	Vend depozitim Maliq	1.54 t	2 km	1.54 h	23 km	0.64	1 km	0.25 h	26 km	2.43 h
			Vend depozitim Maliq	Garazh, Mollaj				23 km	0.64			23 km	0.64 h
		E merkure			1.54 t	2 km	1.54 h	46 km	1.31	1 km	0.25 h	49 km	3.10 h
	E enjte	paradite	Garazh, Mollaj	Floq				9 km	0.24			9 km	0.24 h
			Floq	Kamenice	0.99 t	1 km	0.99 h	7 km	0.20			8 km	1.19 h
			Kamenice	Vend depozitim Maliq	1.32 t	1 km	1.32 h	27 km	0.76	1 km	0.25 h	29 km	2.33 h
			Vend depozitim Maliq	Bellodove				31 km	0.89			31 km	0.89 h
		pasdite	Bellodove	Pulahe	0.41 t	1 km	0.41 h	4 km	0.11			5 km	0.53 h
			Pulahe	Q. Mollaj	0.83 t	1 km	0.83 h	6 km	0.17			7 km	1.00 h
			Q. Mollaj	Vend depozitim Maliq	0.08 t	1 km	0.08 h	25 km	0.70	1 km	0.25 h	27 km	1.03 h
Vend depozitim Maliq			Mollaj				23 km	0.64			23 km	0.64 h	
E enjte			3.63 t	5 km	3.63 h	130 km	3.71	2 km	0.50 h	137 km	7.84 h		
E premte	paradite + pasdite	Garazh, Mollaj	Mollaj				1 km	0.03			1 km	0.03 h	
		Mollaj	Shtylle	1.54 t	2 km	1.54 h	32 km	0.91			34 km	2.45 h	
		Shtylle	Vithkuq	0.08 t	1 km	0.08 h	11 km	0.31			12 km	0.40 h	
		Vithkuq	Leshnje	0.59 t	1 km	0.59 h	5 km	0.14			6 km	0.73 h	
		Leshnje	Gjanc	0.25 t	1 km	0.25 h	5 km	0.13			6 km	0.38 h	
		Gjanc	Vend depozitim Maliq	0.06 t	1 km	0.06 h	37 km	1.06	1 km	0.25 h	39 km	1.37 h	
		Vend depozitim Maliq	Garazh, Mollaj				23 km	0.64			23 km	0.64 h	
E premte			2.53 t	6 km	2.53 h	113 km	3.23	1 km	0.25 h	120 km	6.01 h		

Tabela 6 Performanca dhe kostot direkte të mbledhjes së mbetjeve në zonat rurale – Logjistika e propozuar

Kosto direkte e mbledhjes së mbetjeve		Njësi					Total
			Verilindje	Juglindje	Veriperëndim	Jugperëndim	
Performanca	Mbetjet e mbledhura	t/vit	1,822.1 t	1,224.5 t	1,106.2 t	720.7 t	4,873.4 t
	Distanca e përshkuar	km/vit	29,484 km	37,518 km	31,850 km	28,860 km	127,712 km
	Rrugët e kryera	rrugë/vit	624 trips	624 trips	520 trips	364 trips	2,132 trips
Koha	Udhëtimi	h/javë	4.07	4.76	4.83	4.43	18.09
	Mbledhja	h/javë	35.04	23.55	21.27	12.32	92.18
	Transporti në distancë	h/javë	5.66	7.46	18.72	5.56	37.39
	Shkarkimi	h/javë	3.00	3.00	2.50	1.75	10.25
	Kthimi i mjetit	h/javë	5.01	6.94	6.21	4.99	23.16
	Koha total	h/javë	52.78	45.70	53.53	29.04	181.06
Kosto e pajisjeve	Kamionët e nevojshëm	nr.	1.00	1.00	1.00	1.00	4.0
	Kosto kapitale vjetore	€/vit	5,500 €	5,500 €	5,500 €	5,500 €	22,000 €
	Kosto operative vjetore	€/vit	27,690 €	30,827 €	28,614 €	27,446 €	114,577 €
	Total kosto direkte vjetore	€/vit	33,190 €	36,327 €	34,114 €	32,946 €	136,577 €
Kosto për njësi	Kosto për ton	€/t	18.22 €	29.67 €	30.84 €	45.71 €	28.02 €
	Kosto për km	€/km	1.13 €	0.97 €	1.07 €	1.14 €	1.07 €
	Kosto për rrugë	€/rrugë	53.19 €	58.22 €	65.60 €	90.51 €	64.06 €

1.3 Krahasimi i sistemit aktual dhe të ardhshëm të mbledhjes së mbetjeve

Krahasimi i mbledhjes së mbetjeve siç kryhet aktualisht me përdorimin e 7 kamionëve vetëshkarkues dhe të hapur në zonat rurale të Bashkisë Korçë me sistemin e propozuar për të përdorur 4 kamionë të vegjël kompaktor me itinerare të optimizuara të shërbimit paraqitet në Tabela 7.

Përfundimet kryesore janë:

- Për të mbledhur dhe transportuar në total sasinë vjetore të mbetjeve të prodhuara në zonat rurale të Bashkisë Korçë drejt vend depozitimit rajonal në

Maliq distanca e përshkuar nga 4 kamionët kompaktor është rreth 128,000 km/vit.

Tabela 7 Performanca dhe kostoja në zonat rurale – Sistemi aktual/ Sistemi i propozuar

Performanca dhe kostoja direkte		Njësi	Logjistika aktuale me kamionë të hapur		Logjistika e propozuar me kamionë kompaktor	
Performanca	Mbetjet e mbledhura	t/vit	4,873 t		4,873 t	
	Distanca e përshkuar	km/vit	82,966 km		127,712 km	
	Rrugët e kryera	rrugë/vit	3,640 trips		2,132 trips	
Koha	Udhëtimi	h/javë	18 h	7%	18 h	10%
	Mbledhja	h/javë	196 h	72%	92 h	51%
	Transporti në distancë	h/javë	21 h	8%	37 h	21%
	Shkarkimi	h/javë	21 h	8%	10 h	6%
	Kthimi i mjetit	h/javë	17 h	6%	23 h	13%
	Koha gjithsej	h/javë	273 h	100%	181 h	100%
Kostot e pajisjeve	Kamionët e nevojshëm	nr.	7 units		4 units	
	Kosto kapitale vjetore	€/vit	12,880 €	10%	22,000 €	16%
	Kosto operative vjetore	€/vit	119,064 €	89%	114,577 €	84%
	Total kosto direkte vjetore	€/vit	133,914 €	99%	136,577 €	100%
Kosto për njësi	Kosto për ton	€/t	27.48 €		28.02 €	
	Kosto për km	€/km	1.61 €		1.07 €	
	Kosto për rrugë	€/rrugë	36.79 €		64.06 €	

- Për të njëjtat arsye, koha e punës që nevojitet për 4 kamionët kompaktor është më e shkurtër, me vetëm 181 h/javë (ose 45 h/javë mesatarisht për kamion), krahasuar me 274 h/javë (ose 39 h/javë mesatarisht për kamion) me sistemin ekzistues.
- Ndërsa kursehet kohë duke kryer më shpejt mbledhjen e mbetjeve nëpër fshatra (92 h/javë në vend të 196 h/javë), nevojitet më shumë kohë për

transportin në distancë deri në vend depozitim dhe kthimin (70 h/javë në vend të 59 h/javë).

- Në total kostot vjetore të sistemit të propozuar (137,000 €/vit) janë pothuajse të barabarta me ato të sistemit ekzistues kur llogaritjet bazohen në mjete të reja transporti (134,000 €/vit). Ndërsa kostot kapitale për 4 kamionët kompaktor janë më të larta, kryerja e punës ka rendiment më të lartë.
- Kostot direkte për njësi që lidhen me sasi të mbetjeve që trajtohen sipas sistemit të propozuar (28 €/t) janë pothuajse të barabarta me ato të sistemit ekzistues (27.50 €/t). Për shkak të rritjes së performancës në përkthimin e distancave nga mjetet, kostot për njësi janë më të ulëta (1.07 €/km krahasuar me 1.61 €/km). Kostot për njësi që lidhen me performancën e udhëtimit janë përkatësisht më të larta (64 €/rrugë krahasuar me 37 €/rrugë).

Tabela 8 Ndarja e kostos direkte në zonat rurale – Sistemi aktual/ Sistemi i propozuar

Ndarja e kostos direkte		Logjistika aktuale me kamionë të hapur	Logjistika e propozuar me kamionë kompaktor
Pjesa e kostos që mbulohet nga bizneset	10.0%	11,362 €	13,658 €
Bizneset e shërbyer	nr.	280	280
Mesatarisht pjesa që i takon një biznesi	€/muaj	3.38 €	4.06 €
	Lekë/muaj	ALL 473	ALL 569
Familjet e shërbyera	nr.	10,462	10,462
Mesatarisht pjesa që i takon një familjeje	€/muaj	0.98 €	0.98 €
	Lekë/muaj	ALL 137	ALL 137

1.3.1 Mbledhja e diferencuar e mbetjeve të gjelbra

Mbledhja e mbetjeve të gjelbra do kryhet nga Ndermarja e Shërbimeve Publike duke përdorur kamionët kompaktor të propozuar në bashkëpunim me KRWM për të siguruar në piken e kompostimit që ka krijuar KRWM, kapacitetet në dispozicion të kamionëve vetëshkarkues dhe të hapur mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera si mbledhja e diferencuar e mbetjeve të gjelbra një herë ose dy herë në muaj. Një qasje e ndryshme për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të gjelbra është skicuar në SHTOJCËN 7.

1.3.2 Kompostimi në shtëpi

Një tjetër qasje për të reduktuar sasinë e mbetjeve që duhet të mbledhen dhe të transportohen në vend depozitim është ndërgjegjësimi i banorëve për avantazhet e

përpunimit të lëndëve organike në kopshtin vetjak. Kjo kërkon këshillim bazë mbi aspektet teknike të trajtimit të lëndëve organike dhe mund të zbatohet me kosto minimale. Megjithatë, fushata ndërgjegjësimit intensive janë të nevojshme për të motivuar pjesëmarrjen e banorëve në kompostimin vetjak.

1.3.3 Mbledhja e diferencuar e materialeve të vlefshme

Ne zbatim të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011


PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE


Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet:


- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre;
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.


si dhe direktivave të Bashkimit Europian ne duhet të arrijmë që në fund të vitit 2025 të kemi arritur dhifren e riciklimit 10%



Bashkia do të bëjë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. Për këtë qëllim do të vendosen 100 kazane plastike në qytet dhe nga një në çdo fshat për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme (leter, plastike, qelq, alumin).

Qyteti Korçë		Zona 1/A			
Vendndodhja / Fshati	Banorë	Mbetje të mbledhura		7.0 days/week	
		m ³ /javë	m ³ /vit	t/javë	t/vit
Total	69,447	140.0	7,280.0	24.5	1,274.0
		km/javë		h/javë	
		17.5 km	udhëtimi drejt / midis vendndodhjeve		1.17 h
		70.0 km	mbledhja e mbetjeve		31.50 h
10.0	kapaciteti i kamionit (m ³)	28.0 km	transporti për në vend depozitim		2.92 h
14	rrugë për në vend depozitim/javë	10.5 km	shkarkimi në vend depozitim		2.92 h
140	m ³ /javë	21.0 km	thimi nga vend depozitim / në zonën tjetër		1.17 h
728	rrugë për në vend depozitim/vit	147.0 km	Rrugë e plotë vajtje-ardhje		39.67 h

Qyteti Korçë		Zona 1/B			
Vendndodhja / Fshati	Banorë	Mbetje të mbledhura		7.0 days/week	
		m ³ /javë	m ³ /vit	t/javë	t/vit
Total	69,447	140.0	7,280.0	24.5	1,274.0
		km/javë		h/javë	
		17.5 km	udhëtimi drejt / midis vendndodhjeve		1.17 h
		77.0 km	mbledhja e mbetjeve		38.50 h
10.0	kapaciteti i kamionit (m ³)	28.0 km	transporti për në vend depozitim		2.92 h
14	rrugë për në vend depozitim/javë	10.5 km	shkarkimi në vend depozitim		2.92 h
140	m ³ /javë	21.0 km	kthimi nga vend depozitim / në zonën tjetër		1.17 h
728	rrugë për në vend depozitim/vit	154.0 km	Rrugë e plotë vajtje-ardhje		46.67 h

Qyteti Korçë		Zona 2			
Vendndodhja / Fshati	Banorë	Mbetje të mbledhura		7.0 days/week	
		m ³ /javë	m ³ /vit	t/javë	t/vit
Total	69,447	630.0	32,760.0	110.3	5,733.0
		km/javë		h/javë	
		21.0 km	udhëtimi drejt / midis vendndodhjeve		0.58 h
		140.0 km	mbledhja e mbetjeve		21.00 h
45.0	kapaciteti i kamionit (m ³)	42.0 km	transporti për në vend depozitim		2.92 h
14	rrugë për në vend depozitim/javë	7.0 km	shkarkimi në vend depozitim		2.92 h
630	m ³ /javë	35.0 km	kthimi nga vend depozitim / në zonën tjetër		1.17 h
728	rrugë për në vend depozitim/vit	245.0 km	Rrugë e plotë vajtje-ardhje		28.58 h

Qyteti Korçë		Zona 3			
Vendndodhja / Fshati	Banorë	Mbetje të mbledhura		7.0 days/week	
		m ³ /javë	m ³ /vit	t/javë	t/vit
Total	69,447	630.0	32,760.0	110.3	5,733.0
		km/javë		h/javë	
		21.0 km	udhëtimi drejt / midis vendndodhjeve		0.58 h
		150.0 km	mbledhja e mbetjeve		21.00 h
45.0	kapaciteti i kamionit (m ³)	42.0 km	transporti për në vend depozitim		2.92 h
14	rrugë për në vend depozitim/javë	7.0 km	shkarkimi në vend depozitim		2.92 h
630	m ³ /javë	35.0 km	kthimi i mjetit nga vend depozitimi / në zonën tjetër		1.17 h
728	rrugë për në vend depozitim/vit	255.0 km	Rrugë të plota vajtje-ardhje		28.58 h


Qyteti Korçë		Zonat 2+3			
Vendndodhja / Fshati	Banorë	Mbetje të mbledhura		7.0 days/week	
		m³/javë	m³/vit	t/javë	t/vit
Total	69,447	784.0	40,768.0	137.2	7,134.4
		km/javë		h/javë	
		21.0 km	udhëtimi drejt / midis vendndodhjeve		0.58 h
		210.0 km	mbledhja e mbetjeve		24.50 h
56.0	kapaciteti i kamionit (m ³)	42.0 km	transporti për në vend depozitim		2.92 h
14	rrugë për në vend depozitim/javë	7.0 km	shkarkimi në vend depozitim		2.92 h
784	m ³ /javë	35.0 km	kthimi nga vend depozitim / në zonën tjetër		1.17 h
728	rrugë për në vend depozitim/vit	315.0 km	Rrugë e plotë vajtje-ardhje		32.08 h

SHTOJCA 4 Të dhëna mbi popullsinë, grafikët e mbledhjes së mbetjeve dhe gjendja e rrugëve

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Drenovë
Nr i fshatrave:	9
Nr i banorëve:	7,099
Nr i familjeve:	2,270
Nr i bizneseve të vegjël:	55
Nr i bizneseve të mëdhenj:	21



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	
Kamion vetëshkarkues	1
Rrugë në javë	16
Fusha e mbetjeve	Korça
t/vit	1,098
t/d	3.01
kg/(person·d)	0.42




- Gjetjet kryesore:**
- Mbledhja: 6.30 - 14.00
 - 1 shofer 6 ditë/javë (Jani Trueslia)
 - Kapaciteti i kamionit: 1.7 t për 6 m³
 - Harxhimi i karburantit: 80 l/javë
 - Përbërja e mbetjeve: rreth 35 % mbetje bio (bujqësore)
 - Nevojitet ndërtimi i rrugës (900 m) për të lidhur Turanin me rrugën kryesore (të mos hyhet në qytet)
 - Zape ndodhet pranë Boboshticës në rrugën nacionale
 - Në Dardhë ka një vend për grumbullimin e gjithë mbetjeve

Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premte			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Drenovë	0.75	0.75								0.75	0.75										
Moravë	0.75	0.75		0.75	0.75		0.50			0.75	0.75		0.75	0.75		0.50					
Mborje				1.00	1.00								1.00	1.00							
Boboshticë			0.75				0.75	0.75				0.75									
Qatrom			1.50									1.50									
Ravonik						2.00									1.00						
Dardhë							1.00									0.50					
Bizneset në rrugën nacionale									0.50							1.00					
Turan									0.50						0.75						
Zape																					
total [h]	5.3			5.5			4.0			5.3			5.3			2.0					

Gjendja e rrugëve	rrugë kryesore të asfaltuara [%]	rrugë dytësore të shtruara [%]	pika grumbullimi	Vecori të tjera
Drenovë	100	80	-	të qarkullueshme
Moravë	100	40	-	të qarkullueshme
Mborje	100	40	-	të qarkullueshme
Boboshticë	100	30	-	pjesërisht të qarkullueshme
Qatrom	100	80	-	të qarkullueshme
Ravonik	100	10	-	pjesërisht të qarkullueshme
Dardhë	100	80	1	të qarkullueshme, por rrugë të pjerrëta
Rruga nacionale	100	-	-	të qarkullueshme, bizneset përgjatë rrugës nacionale
Turan	100	70	-	të qarkullueshme
Zape	100	30	-	pjesërisht të qarkullueshme

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Bulgarec
Nr i fshatrave:	13
Nr i banorëve:	14,308
Nr i familjeve:	4,901
Nr i bizneseve të vegjël:	83
Nr i bizneseve të mëdhenj:	23



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	Bulgareci Perëndimor	Bulgareci Lindor
Kamion vetëshkarkues	Kamion vetëshk.	Kamion i hapur
Rrugë në javë	15	15
Fusha e mbetjeve	Korçë	Korçë
t/vit	1,030	1,304
t/d	2.82	3.57
kg/(person-d)	0.39	0.51


Gjetjet kryesore:

- në Bulgarec përdoren kontenierë në rrugët kryesore
- për fshatrat e tjerë nuk rekomandohen kontenierë për shkak të keqpërdorimit nga banorët (hidhen mbetje inerte)
- Nëse kamioni nuk mbushet plot pas mbledhjes së mbetjeve në një fshat, pastrohen edhe pikat e paligjshme të depozitimit pranë fshatrave, para se kamioni të shkarkohet në fushën e mbetjeve
- gjatë rrugëve të mjetit mbledhen edhe mbetjet përgjatë rrugës nacionale
- 1 kamion vetëshkarkues: 420 km/javë dhe 250 l/muaj, 7.00-14.00 (të shtunë deri në 12.00)
- mbetjet bio mesatarisht 30 % (në vjeshtë ~50 %)

Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premte			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Lumallës							1.00									0.50					
Biranj									1.75									1.00			
Melcan							1.00									0.50					
Porodinë	1.75									1.00											
Bizneset në rrugën nacionale		0.50	0.50	0.50	0.50	0.50	0.50	0.50	0.50												
Bulgarec				1.50	1.50	1.25							1.25	1.25							
Ciflig		1.25	1.25							1.50											
Shamoll						1.75									0.50						
Malavec					1.00										0.50						
Kuc i Zi			1.50								0.75										
Belorta		2.25									1.00										
Nevicisht	1.50									0.75											
Dishnicë							1.75	1.75	1.75							1.25	1.25				
Barc				2.50									1.00								
total [h]		10.5			11.0			10.5			5.0			4.5			4.5				

Gjendja e rrugëve	rrugë kryesore të asfaltuara [%]	rrugë dytësore të shtuara [%]	pika grumbullimi	Vecori të tjera
Lumallës	100	30	-	të qarkullueshme
Biranj	0	0	-	qarkullimi me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve
Melcan	70	30	-	pjesërisht të qarkullueshme
Porodinë	0	0	-	qarkullimi me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve
Bulgarec	100	60	-	kryesisht të qarkullueshme (rrugë hyrëse e gjatë)
Ciflig	100	30	-	kryesisht të qarkullueshme (rrugë hyrëse e gjatë)
Shamoll	20	50	-	kryesisht të qarkullueshme, gjendje e keqe e rrugëve
Malavec	10	30	-	qarkullimi me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve
Kuc i Zi	100	30	-	qarkullimi me vështirësi në rrugët dytësore, të ngushta, të pjenëta
Belorta	100	30	-	qarkullimi me vështirësi në rrugët dytësore, të ngushta, të pjenëta
Nevicisht	100	30	-	qarkullimi me vështirësi në rrugët dytësore, të ngushta, të pjenëta
Dishnicë	100	30	-	qarkullimi me vështirësi në rrugët dytësore, të ngushta, të pjenëta
Barc	50	10	1	qarkullimi me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Voskop
Nr i fshatrave:	7
Nr i banorëve:	4,847
Nr i familjeve:	1,251
Nr i bizneseve të vegjël:	55
Nr i bizneseve të mëdhenj:	2



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	
Kamion vetëshkarkues	1
Rrugë në javë	6
Fusha e mbetjeve	Korçë
t/vit	412
t/d	1.13
kg/(person·d)	0.23

Gjetjet kryesore:
Mbledhja e mbetjeve:
- 100 km në ditë
- 7 m³ për rrugë
- mbledhja derë më derë
~ 50 % mbetje bio - kompostim në shtëpi - aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit publik për të rinjtë në Voskop

Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premtë			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Voskop	4.00									4.00											
Polenë				3.00									3.00								
Dërsnik				4.00									4.00								
Goskovë Lart							2.00									2.00					
Goskovë Poshtë							2.00									2.00					
Vincan							2.00									2.00					
Damjanec																					
total [h]	4.0			7.0			6.0			4.0			7.0			6.0					

Gjendja e rrugëve	rrugë kryesore të asfaltuara [%]	rrugë dytësore të shtruara [%]	pika grumbullimi	Vecori të tjera
Voskop	100	pjesërisht	-	të qarkullueshme
Polenë	0	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Dërsnik	0	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Goskovë Lart	0	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Goskovë Poshtë	0	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Vincan	0	0	-	qarkullimi me vëshirësi, gjendje e keqe e rrugëve
Damjanec	0	0	-	qarkullimi me vëshirësi, gjendje e keqe e rrugëve

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Voskopojë
Nr i fshatrave:	5
Nr i banorëve:	926
Nr i familjeve:	293
Nr i bizneseve të vegjël:	34
Nr i bizneseve të mëdhenj:	1



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	
Kamion i vogël i hapur	1
Rrugë në javë	9
Fusha e mbetjeve	afër Voskopojës
t/vit	309
t/d	0.85
kg/(person · d)	0.91


Gjetjet kryesore:

- mbledhja e mbetjeve kryhet me kamion të hapur (të vjetër)
- kapaciteti i kamionit: rreth 4 t, ~3 m³ (2.25 m x 3.75 m x 0.4 m)
- në Voskopojë ofrohet shërbim cdo ditë (5h)
- Të hënë - të mërkurë më pak se 8 h, shoferi punon edhe ditën e diel
- distanca e përshkuar: 500 km/muaj
- harxhimi i karburantit: 350 l/muaj

Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premtë			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Shpiskë	2.0									2.0											
Voskopojë	4.0				2.0		5.0			4.0				2.0		3.5			3.5		
Lavdar				1.0									1.0								
Gjonmadh				3.0									3.0								
Krushovë																					
total [h]	4.0			6.0			5.0			4.0			6.0			3.5			3.5		

Gjendja e rrugëve	rrugë kryesore të asfaltuara [%]	rrugë dytësore të shtruara [%]	pika grumbullimi	Vecori të tjera
Shpiskë	0	0	-	qarkullim me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve
Voskopojë	100	pjesërisht	-	të qarkullueshme
Lavdar	90	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Gjonmadh	90	pjesërisht	-	pjesërisht të qarkullueshme, rruga kryesore e shtruar
Krushovë	0	0	-	qarkullim me vështirësi, gjendje e keqe e rrugëve

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Mollaj
Nr i fshatrave:	6
Nr i banorëve:	5,610
Nr i familjeve:	1,122
Nr i bizneseve të vegjël:	0
Nr i bizneseve të mëdhenj:	0



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	
Kamion i vogël i hapur	1
Rrugë në javë	6
Fusha e mbetjeve	Korçë
t/vit	618
t/d	1.69
kg/(person·d)	0.30

Gjetjet kryesore:

- Mbledhja e mbetjeve kryhet me kamion të hapur (Benz, 1991)
- kapaciteti: 3t ose 9 m³
- Ka plane itinerare javore, të detajuara me oraret e sakta të mbledhjes së mbetjeve
- Shërbim i rregullt cdo ditë, ndonjëherë 2 rrugë për në fushën e mbetjeve të Korçës
- Përmbajtje e lartë mbetjesh organike, ndonjëherë deri në 50%
- Nevojitet kohë e gjatë për t'i ngarkuar mbetjet mbi kamion
- Përdoren disa kosha për mbetjet (120 l)

Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premtë			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Mollaj	5.00			1.00			5.00			1.00			3.00			3.00					
Qendër Komunë	1.00															1.50					
Kamenicë				5.00						3.50											
Ujëbardhë				0.50									1.50								
Pulahë							1.50						1.50								
Floq										2.00						1.50					
total [h]	0.0			5.5			1.5			5.5			3.0			1.5			0.0		

Gjendja e rrugëve	rrugë kryesore të asfaltuara [%]	rrugë dytësore të shtruara [%]	pika grumbullimi	Vecori të tjera
Mollaj	100	90	-	të qarkullueshme
Qendër Komunë	100	90	-	të qarkullueshme
Kamenicë	100	60	-	pjesërisht të qarkullueshme
Ujëbardhë	100	30	-	të qarkullueshme (Ujëbardhë = Bellovodë)
Pulahë	100	60	-	pjesërisht të qarkullueshme
Floq	100	70	-	pjesërisht të qarkullueshme

Bashkia:	Korçë
Njësia administrative:	Vithkuq
Nr i fshatrave:	5/12
Nr i banorëve:	700
Nr i familjeve:	213
Nr i bizneseve të vegjël:	15
Nr i bizneseve të mëdhenj:	



Situata aktuale e mbledhjes së mbetjeve	
Kamion i vogël i hapur	1
Rrugë në javë	3
Fusha e mbetjeve	Gjanc
t/vit	103
t/d	0.28
kg/(person-d)	0.40


Gjetjet kryesore:


- Shërbimi ofrohet vetëm në Vithkuq, Shtyllë, Leshnjë dhe Gjanc
- Mbetjetohen në një fushë mbetjesh pranë Gjancit
- Në Lubonjë shërbimi kryhet nga një person privat i punësuar nga Njësia administrative (me karrocë me kalë)
- 8 nga 12 fshatra janë përjashtuar për shkak të pamundësisë së mjeteve për të qarkulluar ose të distancave të mëdha


Fshatrat	E hënë			E martë			E mërkurë			E enjte			E premtë			E shtunë			E diel		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Shtyllë	1.0						1.0			1.0											
Vithkuq	3.0						3.0			3.0											
Leshnjë	1.0						1.0			1.0											
Gjanc	1.0						1.0			1.0											
total [h]	6.0			0.0			6.0			6.0			0.0			0.0			0.0		


